


Relacion teknik

ID 7.10. Veprimtaritë e lëndës së drurit Pika b: Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.

Subjekti ALB – KORNIZA SHPK

Nipti L84003203J

Zona kadastrale nr. 8622, ndertese 1-kateshe, lagjja nr.4, Kraste, Kruje, Durres.



Vendndodhja e aktivitetit

481260.463
4596055.061


481662.209
4596055.061




481260.463
4595799.561

481662.209
4595799.561

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH



Koordinata Gauss Kruger Zone 4

Pika 1

X	4398043.09
Y	4596826.43

Pika 2

X	4398115.71
Y	4596809.49

Pika 3

X	4398179.34
Y	4596742.24

Pika 4

X	4398119.08
Y	4596677.12

Pika 5

X	4398020.68
Y	4596765.08

Pika 6

X	4397994.79
Y	4596766.78

Pershkrimi:

Aktiviteti prodhon lloje kornizazh te ndryshme (teresia e games se produkteve te mundshem te ofruara) por mund te kemi dhe variacion te tipit ne pershtatje te porosive per dhoma gjumi, kende e divane, soggiorno, zyra, kopshte e cerdhe, portmonto dhe elemete te koheve te fundit. Prodhon dhe sipas porosive dhe modele te tjera te cilat realizohen sipas kerkesave dhe deshirave te klientit.

Struktura funksionale e godinave:

- Magazina ku mbahen te gjitha lendet e para dhe materialet e nevojshme eshte ne katin e pare. Aty jane Zyrat, Ekpozita, Financa (shitjet), ku po ashtu ka magazinimin e aksessoreve dhe pajisjeve.
- Zona e prodhimit/përpunimit ose aty ku mbahet lende e pare ne proces perpunimi dhe sistemimi i produkteve qe perpunohen sipas skemes se prodhimit. Proceset kryesore te prodhimit janë:
 - i. Frezime sipas modeleve.
 - ii. Prerje sipas kerkeses.
 - iii. Prerje te vogla.
 - iv. Ngjitja e tenise, bordim.
 - v. Aspirimi





Si lende e pare perdoret mdf, lend druri, olietan dhe dru i ndryshem ne varesi te kerkesave por ne sasira shume te vogla shume pak lloje te tjere druresh te cilet vijne prane firmes ne formen e elementeve me permasa bruto p.sh 900x60x60. Shoqeria furnizohet me lende drusore te stazhionuar (thare) sipas kerkesave teknologjike te prodhimit por edhe per kerkesa specifike si prodhimit me porosi etj. Gjithashtu si lende e pare perdoren dhe pllakat e zdrukthi, M.D.F, pllaka me shume shtresa ,P.Z e melaminuar etj.

Lendet ndihmese.

Lenda ngjithese qe perdoret eshte ngjites vinilik importohet nga Italia dhe vjen e ambalazhuar ne kuti metalike. Per bojatisjen e objekteve perdoren bojra me baze uji. Per lustrimin e objekteve prej druri perdoren produkte lustrues poliuretanike. Boja dhe te gjitha perberesit e tjere lustrues jane te markes Milesi.

Makinerite dhe paisjet qe perdoren.

Pjesa me e rendesishme nga mirefunksionimi i se ciles varet edhe aktiviteti i firmes eshte padyshim kompleksi i perpunimit dhe i prodhimit te objekteve te gatshme prej druri. Ky kompleks perbehet nga :

- Sektori i preries
- Sektori i perpunimit mekanik
- Sektori i montimit
- Sektori i tapicerise
- Sektori i rifinitures
- Sektori i lyerjes
- Sektori i magazinimit
- Sektori i mirembajtjes etj.

Secili nga keta sektore ka ne perberjen e tij disa makineridhe pajisje ne perputhje me operacionet qe kryhen ne te. Keshtu per shembull mund te permendim:

Sektori I:

prerjes ka ne perberjen e saja keto makina:

- 2 sharra shirit
- 2 makina (sharra) universale

Sektori i II:

perpunimit mekanik ka aktualisht te instaluara keto makineri

- 2 makina Skonikatrice qe mund te kryejne deri ne 8 operacione pune ne nje kalim te detalit
- 1 makine Albitral
- 1 freze per perpunimin e kokave
- 2 makina (shkurim me kend ,birimi)
- 1 freze me bosht vertical
- 2 makina tenonatrice
- 1 makine Orbital
- 1 linje zumparimi per detalet e rrumbullaket
- 1 makine per perpunimin e kokave (2 anesore)
- 1 makine freze vertikale
- 2 makina zumparuese me shirit vertikal
- 1 makine kalibrimi

Sektori i III:

montimit ka aktualisht te instaluara dhe te afta per pune

- 4 makina montimi prodhim italian qe vihen ne pune me presion hidraulik
- 1 makine per godronimin e lidheseve te produkteve

Sektori i IV:

Material kryesor ketu eshte copa e veshjes, sfungjeri dhe te tjere mbushes. Kornizat e tapicuara behen me multistrat (shum shtresa) dhe vishen me tapiceri te ndryshme sipas kerkesave te klientit.

Sektori I tapicerise eshte I paisur me banko pune qe pozicionohen ne lartesi te ndryshme sipas kerkesees se operatorit dhe me dy paisje te cilat jane ne formen e bankos se punes por kane pjese te structures se tyre nje piston pneumatic qe sherben per te fiksuar kornizen gjate veshjes se saj me tapiceri, gjithashtu ky sector ka dhe makina qepese per te qepur tapicerine sipas nevojës.



Sektor V i lustrimit ka:

- 1 kabine lustrimi me dy vende me fushe elektrostатike
- 1 kabine bojatisje
- 1 transportjer i varur

Prane sektorit te lustrimit ndodhet edhe vendi ku behet zumparimi me dore i objekteve, apo elementeve te tjere. Ketu zumparimi behet me dore pasi vete format jane te veshtira dhe nuk kapen nga makinat e zumparimit.

Sektor i VI:

mirembajtjes ka te instaluara

- 2 makina per mprehjen e shiritave te sharres
- 2 makina per mprehjen e disqeve dhe frezave
- 1 pajisje per ngjitjen e shiritit
- 1 pajisje per shtensionim
- 1 trapan vertikal
- 1 torno
- 1 saldatrice
- 1 gur zmeril

Sektor VII:

Se fundmi ne kete sektor eshte instaluar nje linje teknologjike moderne ku ne perbejen e saje ka te instaluara keto makineri:

- Makine sharre disk vertikale. Kjo makine perbehet nga banko e punes e cila eshte e pozicionuar ne planin vertikal dhe ndryshe nga makinat e tjera ku per te kryer sharrimin leviz materiali ne drejtim te instrumentit ,te kjo makin disku preres bend y levizje :levizjen e avanci dhe ate te preries. Disku preres leviz ose sharron ne drejtim vertikal pra nga lart poshte, dhe ne drejtim horizontal nga e majta ne te djathte. Materiali ose pllaka me permasa 3600x1800 vendoset ne

bankon e punes dhe me ndihmen e disa rrotave qe ndodhen ne fundin e bankos behet dhe manovrimi i tij.

- Makine CNC pantograph. Kjo makine eshte e markes Rover te "BIESE" viti prodhimit 1996 dhe kryen operacionin e :frezimit,shpimit dhe sharrimit.Kjo makine perbehet nga dy pjese ajo klasike dhe programimi ku ne baze te kodeve "G0" behet dhe programimi i makines.
- Makine Bordatrice (Rimesimi ne Brinje).Kjo makine kryen operacionin e rimesimit ne brinje te detaleve si P.Z te melaminuara M.D.F etj. Makina eshte e markes Olimpik K-1000 te S.C.M. Si material per rimesimin e pjeseve perdoret P.V.C , A.B.S me spesore te ndryshem 0.4 m/m ,1 m/m, 2 m/m etj, kjo makine rimeson dhe dru me gjeresi 55 m/m dhe spesor deri 12 m/m.
- Makine bordatrice manual. Keto 2 makina sherbejne per te bere rimesimin e pjeseve te harkuara ose rethore, ka te njejtin parim si olimpik K-1000 vetem se ne keto makina ngjitja e bordit dhe heqia e pjeseve te teperta te bordit behet ne dy makina te vecanta pra njera e ngjit dhe tjetra e pret.

Procesi teknologjik i prodhimit.

Lenda e pare ne punishte vjen ne formen e detaleve me permasa bruto. Procesi i punes vijon me repartin e perpunimit mekanik. Ne kete repart behet prodhimi i elementeve te produkteve si dhe perpunimi i tyre ne koka. (per detalet cilindrike).

"Zemra" e ketij reparti dhe e veprimtaris eshte nje linje teknologjike qe konsiston ne nje seri stacionesh pune te automatizuara qe realizojne veprime perpunuese. Transporti i pjeseve midis stacioneve eshte i automatizuar.

Nder detalet qe prodhon kjo linje mund te permendim:

883 mm gjatesi dhe $\Phi = 42.5$ mm

463 mm gjatesi dhe $\Phi = 42.5$ mm

710 mm gjatesi dhe $\Phi = 40$ mm

400 mm gjatesi dhe $\Phi = 21$ mm

750 mm gjatesi dhe $\Phi = 40$ mm

1040 x 48 x 48 mm

730 x 48 x 48 mm

730 x 58 x 58 mm

1150 x 56 x 48.3 mm

300 x 40 x 20 mm

463 x 47 x 47 mm

405 x 42 x 21 mm

923 x 42 x 42 mm

Pergjithesisht keto detale vinje me nje mbishtese rreth 2-4 cm ne gjatesi dhe 5-8 mm ne gjeresi dhe trashesi.

Makina orbital ben thyerjen e brinjeve te detaleve me seksion drejtekendor dhe problemi qe shfaqet dendur eshte nje valezim i brinjes se detalit qe punohet. Ky problem shkaktohet nga paqendrueshmeria e detalit gjate punes (mos perputhja e bangos se punes me hapsiren punuese te shiritave).



Makina albitral ben punimin e produkteve, apo elementeve te tjere te kerkuar ne baze te nje shablloni te parapregatitur me pare. Dy frezat e vendosura anash detalit ndjekin levizjen e kushinetave qe jane ne Skeme e makines orbital kontakt me shabllonin duke i dhene keshtu atij formen e shabllonit.

Ne kete repart jane te instaluara dhe makina e shpimit berjes se femres dhe ajo e berjes se mashkullit.

Makine shpimi: Ne repartin e perpunimit mekanit eshte e instaluar edhe nje freze qe perdoret kryesisht per te bere folete per kornizat e jashtme

Sipas vazhdimesise se procesit te prodhimit kalojme ne repartin e montimit. Ne repartin e montimit zakonisht per ritme normale pune jane ne pune 2 makineri, njera qe ben lidhjen shtresave

Reparti bojatisjes dhe lustrimit: Reparti i fundit qe merret me perpunimin e produkteve eshte reparti i Bojatisjes, lustrimi. Ne kete repart behet bojatisja dhe lustrimi i produkteve sipas porosise qe eshte marre. Ky repart perbehet nga nje kabine bojatisje dhe nje kabine lustrimi me fushe elektrostатike. Pasi objektet bojatisen varen ne konvejerin e varur deri sa te thahen me pas i jepet pasta dhe dora e fundit jepet lustra. Pasi produktet kane mare llakun i montohet suporti dhe ambalazhohen.



Procesi teknologjik i bojatisjes se drurit, metodat, makinerite, parametrat.

Per bojatisjen e drurit perdoren bojra me baze uji. Pasi elementi ka perfunduar operacionin e zuparimit me shajak, i nenshtrohet operacionit te bojatisjes duke e zhytur ne kazanet e bojes ose/dhe bojatisjes me pompe sipas ngjyres se deshiruuar si p.sh : qershi, arre dhe venge qe jane bojrat me te perdorura ne kete firme.

Per bojatisjen e drurit perdoret metoda me zhytje me dore. Pasi pjeset e elementeve te produkteve ka mare plotesisht bojen ajo lihet te kullohet ne bankon me vrime te kullimit te tepricave te bojes.

Procesi teknologjik i lustrimit te tejdukshem (metoda, makinerite dhe parametra).

Procesi taknologjik i lustrimit realizohet ne kabina lustrimi me elektrosprucator dore dhe me paisjet e tij.

Elementi pasi eshte bojatisur, zuparuar dhe eshte bere gati per lustrim ose per ti dhene pasten (fondon) vendoset ne kabinen e lustrimit ku jane te instalur dy suporte te cilet rrotullojne elementet menyre qe te behet lustrimi nga te gjitha anet e saje.

Elementet pasi jane vendosur ne syportin e rrotullueshem, me ndihmen e pistoletes me fushe elektrostetike ose elektrosprucatorit dhe paisjeve te tije behet lustrimiose pasta elementeve.

Materialet lustrues qe perdoren jane te pershtatshme per lysterjen me fushe elektrostetike. Ato jane me baze vaji, poliester, me baze rreshire sintetike etj.

Procesi teknologjik i tharjes se mbulesave.

Procesi teknologjik i tharjes se mbulesave te finesimit realizohet ne konvejerin e varur qe ndodhet ne repartin e bojatisjes dhe lustrimit. Tharja e bojes apo cipes se llakut realizohet si pasoje e avullimit te solventeve ose tretesve qe permban produkti lustrues , pra kemi te bejme me tharie fizike te produkteve.

Koha e tharjes eshte variabile duke mos pasur nje regjim konstante te temperatures se ambientit megjithate koha e tharjes mund te shkoje nga 10 -30 minuta kjo ne varesi te temperatures se ambientit dhe raporteve perzierjes.

Mbrojtja ne pune.

Vecoria specifike e e procesit te lustrimit eshte clirimi i nje sasie te konsiderueshme te solventeve qe ndotin ajrin e mjedisit te punes te punes. Clirimi i avujve te solventeve te produkteve lustruese ndodhin gjate shtrimit te mbuleses dhe gjate tharjes se saje.

Avujt e solventeve kane veprim toksik (helmues) mbi organizmin e njeriut. Veprimi toksik kane dhe pluhurat qe formohen gjate zuparimit te drurit ose gjate zuparimit te thate te lustres. Per kete arsye te gjitha punetoret e aktivitetit jane te paisur me maska qe filtrojne ajrin qe puntori thith dhe ne menyre te vecante punetoret qe punojne prane kabines se lustrimit dhe

bojatisjes jane te pajisur me kundra gaze me filter karboni te cilet bejne nje filtrim te mire te ajrit.

Gjate sprucimit ekziston rreziku i intoksikacionit nga disa perberes se produkteve, rreziku i zjarrit dhe eksplozionit qe lidhet me pranine e solventeve te djegshem. Per kete qellim lustrimi i drurit kryhet ne kabina qe sigurojne mbrojtjen e puntorit kunder rrezikut te intoksikacionit, zjarrit dhe te eksplozionit.

Kabina e lustrimit dhe bojatisjes eshte e pajisur me filtra te thate dhe me ventilatore te fuqishem qe nxierrin ajrin e demshem jashte kabines se lustrimit.

Kabinat e lustrimit dhe te bojatisjes si dhe te gjithe paisje qe perdoren ne repartin e bojatisjes dhe lustrimit i neshtrohen mirmbajtjes dhe pastrimit ne menyre periodike, gjithathtu behet dhe qarkullimi i ajrit ne gjithe repartin e bojatisjes dhe lustrimit.

Organizimi i vendeve te punes.

Per sprucimin e produkteve perdoret kabina, ku objekti ose detali qe do te sprucohet vendoset ne bankon levizese. Punetori duke u ndodhur jashte kabines , drejton pistoleten e sprucimit ne hapesiren e kabines drejt produktit dhe duke u rrotulluar produktin ben sprucimin e saj ne menyre uniforme. Zhvendosja e produktit nga tavolina e rrotullueshme dhe vendosja e saj ne transportierin e varur behet nga punetori ndihmes. Ngarkimi dhe shkarkimi i produkteve ne kabine behet nga puntore ndihmes nepermjet hapesires ballore te kabines.

Pasi produktit i eshte dhene paste ajo vendoset ne transportierin e varur ku lihet te thahet. Pasi produkti ka kryer nje rrotullim te plote ne konvejer ,meret nga puntori dhe vendoset ne bankon e punes per te realizuar zumparimin. Zumparimi behet prane kabines se lustrimit ne bankot e punes te cilat kane te montuar ne pjesen e poshtme te saj tuba te transportit pneumatik dhe nepermjet vrimave qe ka syprina e bankos largohen plurat qe rezultojne gjate operacionit te zumparimit.

Kontrolli cilesor

Tashme me nje aktivitet disa vjecar ne fushen e perpunimit te drurit ka konsoliduar marredhenjet me partneret e saj vendas dhe te huaj.ne kontrat mes tyre nuk flitet me per kushtet cilesore te mallit por per sasine qe nevojitet.

Marredhenje te mira jane vendosur me firmen italiane "Milesi" nga te cilat importohen produktet e lustres dhe me firmen turke "Papatya" nga e cila importohen objektet plastike.Keto sjellin produkte cilesore dhe i qendrojne besnike kontratave.

Ne ndonje rast lind nevoja per te blere nga firmat shqiptare elemente per stabilizim e fiksim te struktures. Nje kontroll i rrepte cilesie aplikohet ne detalet qe prodhon makina skonikatrice.Nqs detalet kane plasaritje ne koka ose gjatesore at skartohetn,po ashtu ndodh edhe nqs detalet kane nje sado e vogel qofte ajo. Nqs ne detale kemi gjurme nga instrumentat te cilat nuk largohen as nga zumparimi i tyre ato detale gjithashtu skartohen.

Karakteristikat e makinave

Me siper eshte folur per makinat e instaluara ne repartet e ndryshem ndersa ne tablen e meposhtme jepet nr i elektromotoreve,fuqia e tyre,shpejtesia e rrotullimit.

Makina	Nr elektromotoreve	Fuqia (kw)	Nr rrotullimeve (rr/min)
Skonikatrice	4	3	2880
	2	4	2850
	2	5.5	2870
	1	2.2	950
Albitral	2	4	2885
Multilame	2	45	2940
Makine birimi	4	1	460
	12		6000
Tenonatrice	2	1.5	2830
Makine kalibrimi	2	10	
	2		
Makine kalibrimi vertikale	1	4.5	1400
Orbital	2	0.26 te avancit	
	1	5	1390
Pendul shkurtimi	1	3	2870
Sharra shirit	1	5.5	1450
Sharre vertikale	1	4.5	2870
Makine bordatrice	4	3	2880
	2	4	2850
	2	5.5	2870
	1	2.2	950
Makine Universale	2	4	2870

Keto jane makinat qe perdoren me shpesh gjate procesit teknologjik. Keto makineri perdorin instrumente te ndryshem te profileve te ndryshme.Me te perdorur jane shiritet prerres,disqet,puntot dhe modulet e frezave.Me pak mund te permendim guret zmerile,thikat e planit dhe thikat e tornos.Guret zmerile dhe thikat e tornos perdoren ne oficine ne rastet kur pregatiten detale metalike qe sherbejne per funksionimin e makinerive te perpunimit te drurit.

Konsumi i lendes se pare, lendeve ndihmese, energjise elektrike etj..

Gjate periudhes 2009-2010 jane konsumuar:

- Konsum i energjise elektrike:

Jane shpenzuar afersisht 336000 kwh energji elektrike, mesatarisht 28000 kwh ne muaj,

- Konsum i ujit:

Jane konsumuar 0.2 m³ ujes si perberes ne procesin teknologjik dhe per nevoja higjeno-sanitare.

Konsumi i lendes se pare :

Material drusor, pllake melamine, pllake M.D.F total vjetor 100m³ ,mesatarisht 10 m³ ne muaj (tallash 15 % e sasise ne m³).

Sasia e tallashit te prodhuar ka qene 6% e melamines dhe e M.D.F per drurin rezulton 15 % e sasise ne m³ te perdorur.

Mbetjet teknologjike perdoren per djegie per nevoja sociale dhe nje pjese e tallashit qe rezulton gjate procesit teknologjik perpunohet per te prodhuar briketa te cilat tregtohen per konsumatorin per tu perdorur ne stufa per ngrohje.

- Shtesa:

Ngjites 600 kg mesatarisht 50 kg ne muaj,

Solvente te ndryshem si: llak, katalizator, diluent, fondo, etj..2600 litra ne muaj dhe ne vit 31200 litra ne vit.

Transporti i brendshem

Sistemi i transportit perfaqesohet nga kater menyra transporti

1. Transport pneumatik (transporti i tallashit nga makinat te grumbulluesi)
2. Transport me transportjer me shirit dhe me rula me zinxhir
3. Transport me tanspaleta dhe makina pirun
4. Transport me krahe

Kushtet e punes, mbrojtja ne pune, sigurimi teknik

Aktiviteti pergjithesisht ofron kushte te mira pune sigurisht kjo edhe ne varesi te vendit te punes. Fillimisht punetoret i pastrohesh vendi i punes ,atrecohet makina per pune, dhe i dorezohet makina per te punuar. Ketij punetori i jepet maske per tu mbrojtur nga pluhurat dhe doreza per te mbrojtur duart. Perdorimi i maskave, dorezave dhe mbajtja paster e vendit te punes i lihen ne pergjegjesine e punetorit dhe kontrollohet nga inxhinjeri.

Persa i perket masave te marra per sigurimin teknik mund te permendim tabelat e vendosura perballe vendit te punes, pajisjes me maska dhe doreza. Punetoret duhen instuktuar rregullisht per sigurine ne pune.

Per nje pune pa aksidente nuk lejohet qe:

- gjate punes te perdoret celulari
- te degjohet muzike me kufje
- te ndalohen instrumentt me copa druresh
- te largohen nga vendi i punes dhe te lenë makinën ndezur (nuk duhet te largohen fare)
- te nderhyje vete punetori ne makineri
- te leshohet per pune menjehere pasi eshte riparuar
- te mos jete banko e punes e paster
- te mos kontrollohen mire lidhjet elektrike dhe gjendja mekanike
- te kemi burime shperqendrimi
- te behet roli i ekspertit
- te futen duart ne makina kur ato jane te ndezura
- te punojne makinat edhe kur ato dyshohen per defekte
- te mos pastrohet vendi i punes
- te perdoren priza thyera dhe te rrezikshme.

Keto makineri perdorin instrumente te ndryshem te profileve te ndryshme. Me te perdorur jane shiritet prerës, disqet, puntot dhe modulet e frezave. Me pak mund te permendim guret zmerile, thikat e planit dhe thikat e tornos. Guret zmerile dhe thikat e tornos perdoren ne oficine ne rastet kur pregatiten detale metalike qe sherbejne per funksionimin e makinerive te perpunimit te drurit.

Kapanonet qe jane ne funksion te veprimtaris te cilat jane te perbera nga reparte specifike te perpunimit te drurit jane kapanone kryesisht me strukture metalike dhe te veshura me materiale termoizoluese, si te tipit sandwich. Menyra e operimit dhe pozicionimit te tyre eshte bere ne baze te projektit arkitektonik ne menyre qe te jete sa me funksionale dhe te jene ne funksion te njera-tjetres.

Ambjentet e jshteme te punishtes jane te rregulluara dhe sistemuara ne mire dhe kane nje mirembajtje ne menyre te vazhdueshme. Objekti eshte i pajisur me te gjitha kondicionet e nevojshme, me siperfaqe dhe ambiente hidrosanitare, me sistem ajrimi dhe kondicionimi per disa ambiente, me sistem zjarrfikës ne te gjitha repartet duke siguruar sasi te konsiderueshme uji nepermjet sistemit te furnizimit nga rrjeti per kete qellim edhe pse procese teknologjike me uje nuk ka. Gjithashtu ne godine nuk mungojne edhe hidrantet dhe bombulat e fikjes.

Energjia elektrike eshte e siguruar nepermjet nje kabine te posatshme per te mundesuar energjine elektrike ne nivelet e duhura, sistemi i kanalizimeve eshte i lidhur me ate te rrjetit te zones.

Stafi i kesaj veprimtari eshte i paisur me te gjitha mjetet dhe kushtet e domosdoshme te punes duke pasur mundesine per tu shmangur pothuajse 100% efekteve te mundeshme te kesaj lloj veprimtarie, jane vene ne dispozicion maska te ndryshme per filtrimin e ajrit me fibra karboni,

maska kundragazi te cilat jane ne dispozicion per punonjesit e repartit te bojatisjes dhe zumparimit.

Periudha kohore e funksionimit te punishtes dhe personelit te punesuar eshte 5-6 dite ne jave si dhe perjashtohen nga ditet e punes edhe ditet e pushimit te festave zyrtare. Stafi i kesaj shoqerie kryesisht eshte nga zona perreth por nje pjese e tyre edhe nga zona te tjera ku mund te permendim stafin drejtues, etj.

Personeli qe punon eshte i perhershem dhe 3-4 sezonal.

Kuadri ligjor:

Vendimi Per terheqjen e mendimit te publikut ne vendimarrje per mjedisin, pjesmarrja e publikut te ndikuar

1. Pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, strategjive, rajonale e kombëtare, të përgjithshme dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumentave, që përmirëson përmbajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre .

2. Autoritetet publik gjatë procesit të hartimit të dokumentave të përmëndura në pikën 1, të këtij kreu, pjesëmarrjen e publikut të ndikuar e realizojnë:

a. duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm për këto dokumenta;

b. me përcaktimin e rregullave dhe procedurave sa më të thjeshta;

c. me sigurimin e kushteve dhe të zgjidhjeve praktike, të përshtatshme për tërheqjen e mendimit të tij.

3. Për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe kontributin e tij, autoritetet publike zbatojnë procedurat, si më poshtë vijon:

a. Në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e dokumentit të hartuar, identifikojnë atë , që përbën publikun

e ndikuar për rastin konkret;

b. Organizojnë njoftimin e publikut të ndikuar, se është hartuar projekti i dokumentit që do të bëhet objekt i debatit publik dhe e ftojnë publikun të njohet me të e të përgaditet për debat.

4. Njoftimi i publikut të ndikuar shpallet :

a. në radio e tv, kombëtare e vendore;

b. në faqen e internetit të autoritetit;

c. në botime, të përditshme apo periodike, nëse është e mundur;

d. në tabelën e njoftimeve, në vend të dukshëm.

5. Grupi hartues i dokumentit e ripunon atë, duke marrë parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku, që vlerësohet i vlefshëm, dhe harton relacionin, që shoqëron projektdokumentin, ku pasqyrohen vërejtjet e publikut, që nuk janë reflektuar në të, duke shpjeguar edhe arsyet pse nuk janë marrë parasysh.

6. Relacioni i përcillet organit vendimarrës, së bashku me projektin përfundimtar të dokumentit e me procesverbalin e debatit me publikun.

Sipas Ligjit Nr: 10448 date 14/07/2011 "Per lejet e Mjedisit", aktiviteti klasifikohet ne leje B" konform Shtojces I.

Elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit

Elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit qe jane gjithashtu detyrimisht te zbatueshme edhe per qe zhvillon aktivitetin e saj, te pershkruar ne kete raport VNM -je jane:

- a) parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera te cdo lloji;
- b) ruajtja e shumellojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore, biogjeografike te vendit;
- c) përdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre;
- ç) riaftësimi ekologjik i zonave te dëmtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukuritë natyrore shkatërruese;
- d) ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimi i cilësisë se jetës

Gjate vënies ne pune te veprimtarive dhe instalimeve, personat fizike e juridike sigurojnë:

- a) zbatimin e te gjitha masave qe parandalojnë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit;
- b) shmangien dhe pakësimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakësuar ndikimin ne mjedis;
- c) parandalimin e aksidenteve industriale dhe kufizimin e pasojave te tyre;
- ç) kthimin e vendit ne kushte te kënaqshme mjedisore pas përfundimit te veprimtarisë;
- d) njoftimin për çdo ndryshim te planifikuar te linjës teknologjike;
- dh) respektimin e kërkesave dhe te kushteve te lejes mjedisore;
- e) njoftimin e agjencive rajonale te mjedisit, jo me rralle se një here ne 3 muaj, për rezultatet e vetemonitorimit dhe, ne çdo kohe, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ ne mjedis;
- ë) plotësimin e kërkesave te Inspektoratit te Mjedisit gjate kryerjes se kontrollit te veprimtarisë se tyre;
- f) njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor te veprimtarisë se tyre;
- g) mbajtjen e regjistrave për shkarkimet ne mjedis, për përdorimin e ujit dhe te energjisë, si dhe për teknikat e përdorura.

Politikat Kombëtare për Mjedisin

Ligji për mbrojtjen e mjedisit përcakton dhe politikat shtetërore për mjedisin .Ky raport VNM-je përmbush dhe është në përputhje me këtë nën mbi politikat shtetërore për mjedisin si më poshtë :

1. Politika shtetërore për mbrojtjen e mjedisit synon zbatimin e kërkesave të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë për mjedisin. Në hartimin dhe zbatimin e saj angazhohen të gjitha organet shtetërore, secili në linjën e vet.
2. Organet shtetërore të ngarkuara me ligj për administrimin e përbërësve të mjedisit në politikat sektoriale, kombëtare e vendore, si transport, energji, bujqësi, turizëm, industri, shërbime, rregullim territori e zhvillim ekonomik e shoqëror, në tërësi, sigurojnë harmonizimin e zhvillimit ekonomik e shoqëror me mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Kuadri Ligjor Vendor dhe Nderkombëtar

Hartimi i kësaj VNM -je për zhvillimin e zonës së projektit të përshkruar në kapitujt në vijim, është i mbikëqyrur nga disa institucionet qendrore dhe ato lokale për zbatimin me rigoroz të të gjitha ligjeve dhe normave të parashtuara në ligjet përkatëse sipas institucioneve dhe kopentecave të tyre. Në bazë të legjislativitetit, ky aktivitet ndiqet nga këto institucione :

- Ministria e Mjedisit, ujërave dhe pyjeve;
- Ministria e Bujqësisë;
- Bashkitë dhe Komunat përkatëse në të cilën zona e projektit bën pjesë administrativisht
- Instituti i mjedisit.;
- Instituti Hidrometeorologjik;

Kuadri ligjor vendor Legjislativiteti mjedisor është ndertuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit. Kështu, ndër me specifiket mund të përmendim:

- Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin Ndikimit në Mjedis”
- Ligjin Nr .10 431, datë 9.6.2011 “ Për Mbrojtjen e Mjedisit “
- Ligji 10448 date 14/07/2011 “ Për lejet e Mjedisit “
- Ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010’Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr8897 date 16/5/2002 ‘Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja “
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” .
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
- Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005, “Për efikasitetin e energjisë” .

- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"

- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura".I ndryshuar me:

Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996: "Për largimin publik të mbeturinave"

- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003: "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" I ndryshuar me

:Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- Ligji Nr.8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" I ndryshuar me:

Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005

Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008

- Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" I ndryshuar me:

Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- VKM. Nr. 835, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi"

- V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"

- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006, "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor

- V.K.M Nr.435 datë 12.09.2002, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në

Republikën e Shqipërisë"

- V.K.M Nr.267, datë 24.4.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike"

- V.K.M Nr.994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin".

- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"

- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"

- VKM Nr.114, datë 27.01.2009 për “Marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.
 - Vendim Nr.824, datë 11.12.2003 Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme
 - Udhezim Nr.6, datë 27.12.2006, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”
 - Udhezim Nr.6527, datë 24.12.2004, “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre”
 - Udhezim, Nr.5, datë 28.12.2007, “Për tarifat e shërbimit për lejet mjedisore”.
 - Udhezim, Nr.6, datë 27.11.2007, “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”.
 - Udhezim, Nr.1, datë 07.01.2008, “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”.
 - Rregullorja Higjieno-Sanitare datë.17.11.1997: “Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave”;
 - Rregullore, Nr.1, datë 30.03.2007, “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre”. Kuadri Ligjor Nderkombëtar Shqiperia është një vend i cili është tashmë nënshkruar nga shumë konventave dhe marrëveshjeve mjedisore
- dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ky raport duhet të përshkruajë me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe me poshtë ilustron në mënyrë të përbledhur etapën kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit .
- Protokollin e Kievit :Për vlerësimin strategjik mjedisor.Ratifikuar në vitin 2005
 - Protokollin e Kartagjens:Për biosigurinë .Bere pale ne vitin 2005
 - Konventa e Stockholmit:Mbi ndotesit organike te qendrueshem. Ligji nr. 9263, date 29.07.2004
 - Protokollin e Kartagjens :Për sigurinë biologjike .Ratifikuar ne vitin 2004.
 - Ligji nr. 9279, date 23.09.2004
 - Konventa e Washingtonit:Për tregjetin nderkombetare te llojeve te rrezikuara te flores dhe faunes se eger.

Ligji nr. 9021, date 06.03.2003

Kuadri Ligjor European

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqsë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezkshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujerave të embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.

Referimet në nivel komunitar në fushën e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta dhe për qëllimet tona është e dobishme të perzgjidhen ato me kryesoret.

Disa nga parimet themelore, parimet baze, që sugjerojnë linjat e veprimit dhe objektivat që përmbajnë programet komunitare, po i pershkruajme me poshte.:

A. PARIMET KRYESORE.

Referimi themelor juridik i Bashkimit European është themeluar nga "Traktati që krijon kushtetutën për Europën, që dikton parimet themelore të Komuniteti European". Në kuadër të mbrojtjes së mjedisit "Traktati" parashton arritjen e disa parimeve që përmbliidhen në mënyrë specifike në Seksionin e 5 të Mjedisit- Artikulli III-129 (ish artikulli 174 TKE,) që sillet si më poshte në mënyrë të integruar.

1. Politikat e BE ne fushen mjedisore kontribuojne ne arritjen e objektivave te meposhtem:

a) ruajtja, mbrojtja dhe permiresimi i cilesise se mjedisit;

b) mbrojtja e shendetit njerezor;

c) perdorim te shkathet dhe racional te burimeve natyrore;

d) promovim ne planin nderkombetar te masave per zgjidhjen e problemeve te mjedisit ne nivel rajonal dhe boteror

2. Politika e BE ne fushen mjedisore synon ne nje nivel te larte kujdesi, duke patur parasysh diversitetin e situatave ne rajone te ndryshme te Bashkimit European. Eshte krijuar mbi parimet e masave paraprake te aksioneve te parashikuara, mbi parimin e korrektimit ne menyre prioritare ne burim te demeve mjedisore dhe mbi parimin "kush ndot paguan".

3. Per te nxitur politiken ne fushen e mjedisit duhet te kihen parasysh:

a) te dhena shkencore dhe teknike ne dispozicion;

b) kushtet e mjedisit ne rajone te ndryshme te BE;

c) avantazhet dhe perfitimet, qe mund te rrjedhin nga veprimi ose mungesa e aksionit;

d) nga zhvillimi social-ekonomik i BE ne teresine e tij dhe ne zhvillimin e ekuilibruar te rajoneve te vecanta.

4. Ne kuader te kompetencave respektive, BE dhe shtetet anetare, bashkepunojne me vendet e treta dhe organizatat nderkombetare kompetente. Modalitetet e bashkepunimit te BE mund te krijojne object marreveshje midis tyre dhe te treteve te interesuar.

Parimet baze ku mbeshtetet :

A. Parimi i Parandalimit. I futur ne politiken mjedisore europiane, qe nga programi i pare i veprimit si nevojte per te "evituar qe ne fillim ndotjen dhe shqetesime te tjera, para se te luftosh me vone efektet" mbi cilesine e jetes dhe mbi ambientin, eshte zhvilluar ne menyre te vecante ne programin e dyte te veprimit, qe ka formuar bazen e tratkateve (duke filluar nga akti i vecante europian i 1986) me strukturen e udhezimit komunitar mbi mbeturinat te 1975 te modifikuar ne 1991.

B. Parimi "Ndotsi Paguan ". Nje parim i tille i ardhur nga bota e ekonomise, gjen beshtetje ne menyre te gjere ne fushen e ligjeve dhe permban promovimin e iniciativave ne fudhen e pergjegjesise civile. Nje parim i tille, i futur ne nivelin ligjor te udhezimit 94/62/CE mbi amballazhet dhe mbeturinat e amballazheve, eshte riafirmuar nga direktiva e re ne kete fushe (2004/12/CE), qe parashikohet ne menyre specifike ne nenin 4, mundesia per te realizuar "projekte intensive per te paraqitur pergjegjshmerine e prodhuesit". I njejt parim ka njohur nje zhvillim te metejshe ne planifikimin e disa masave te pershtatura ne nivel europian ne lidhje me perdorimin e automjeteve, baterive, paisjeve elektrike dhe elektronike, etj.

B. "Parimi I Nivelit të Lartë të Mbrojtjes Mjedisore". Koncepti i nivelit të lartë të mbrojtjes

mjedisore fillimisht u paraqit nga Akti unik Europian (1986), në kuadër të pershkrimeve që u takojnë tregjeve të vetëm, në relacion me masat përfunduese të legjislativës kombëtare; e cila gjeti konfirmim në Traktatin e Maastricht-it (1992) dhe më vonë në Traktatin e Amsterdimit (1997).

C. "Parimi i subvencionit të Ndhimes Ekonomike". Siç është vendosur nga "Akti unik europian" dhe më pas nga "Traktati i Maastrichtit", në fushën mjedisore, dhe në mënyrë më specifike në sektorin e mbeturinave, vlen parimi tradicional i respektimit të nivelit normativ më të pershtatshëm të nderhyrjes.

E. Parimi i Menaxhimit pa Rreziqe për Mjedisin/Shëndetin Publik. , një rregull thelbësor në

fushën e mbeturinave, përpara parashikohet në nenin 4 të udhëzimit të pershkruar, është absolutisht e ndaluar hedhja e mbeturinave në mënyrë të pakontrolluar që detyrimisht këto mbeturina duhet tu nënshtrohen shërbimeve për shpërberjen, rikuperimin, ose trajtimin nga ana e vetë prodhuesit n.q.s është në gjendje ta bëjë.

F. "Parimi i integritetit." koncepti i nevojës për të integruar tematikën mjedisore në fushën e politikave të tjera komunitare ka qenë qartësisht i shprehur shumë herë në fushën e traktatëve europiane. Në linjë të përgjithshme, bazuar mbi traktatin e Amsterdimit "nevojat relative me mbrojtjen e mjedisit duhen të integrohen në përcaktimin dhe implementimin e politikave dhe nderhyrjeve të BE" Shqipëria ka firmosur shumë konventa dhe protokolle ku mund të përmendim disa prej tyre:

- Konventën e Aarhus për akses në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendim marrje ambjentaliste dhe akses të drejtësisë në çështjet ambjentaliste, të ratifikuar me Ligjin Nr.8672, datë 26 tetor 2000.
- Konventa Ndërkombëtare Detare "Për Përgatitjen Ndaj Ndotjes Nga Nafta, Reagimi Dhe Bashkëveprimi (Oprc), 1990" Ratifikuar Nga Rsh Me Ligjin Nr.9692, Datë 8.3.2007;
- Konventën Ndërkombëtare "Për Përgjegjësinë Civile Për Dëmet Nga Ndotjet Me Karburant", 1992, Ratifikuar nga RSH me Ligj Nr.9293, datë 21.10.2004;
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, më 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës Në Bernë, 19 shtator 1979
- Konventën e Rio De Janeiro-s për Biodiversitetin, të ratifikuar më 10 nëntor 1996,
- Konventa Ndërkombëtare Detare "Për Parandalimin e Ndotjeve Nga Anijet, 1973"